Bashkëlidhur listë verifikimi i plotësuar gjatë inspektimit.

9. Në rast se nuk konstatohen shkelje të jepen arsyet e përfundimit të procedimit.**III. KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE**

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. __ datë __ / __ / __ / nenit/eve __ ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:



1. Dënim administrativ kryesor:
 - a. _____;
 - b. _____;
2. Dënim administrativ plotësues:
 - a. _____;
 - b. _____;
 - c. _____;

Shkeljet e kërkesave ligjore për t'u korrigjuar:

Bashkëlidhur fletë shoqëruese për këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.

Bashkëlidhur dokumente që inspektori vendor i gjykon të nevojshme për procesin e inspektimit.

IV. VENDIMI PËRFUNDIMTAR

Vendim përfundimtar i veçantë

Po ☐

Jo ☐

Nëse Po Vendimi përfundimtar ngarkohet në sistem.

Nëse Jo Vendimi përfundimtar kur nuk janë konstatuar shkelje ligjore, pasqyrohet më poshtë:

V. FORMALIZIMI

Ky procesverbal u mbajt sot më datën ____/____/____ dhe pasi lexohet nënshkruhet si më poshtë:

INSPEKTORËT:

Inspektor 1 NUI (Nënshkrimi)

Inspektor 2 NUI (Nënshkrimi)

Inspektor 3 NUI (Nënshkrimi)

PËRFAQËSUESI I SUBJEKTIT:

Emër Mbiemër (Nënshkrimi)

Procesverbali i njoftohet subjektit brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit.



Formati Nr. 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA
INSPEKTORATI VENDORVENDIMI I NDËRMJETËM
PËR
MARRJEN E MASËS URGJENTE

Nr. III/00000007/VN

Datë ____/____/____/

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja : _____

Emri i Punëdhënësit: _____

Në bazë të gurmës _____ (a ose b, në varësi të rastit përzgjidhet nga sistemi) të pikës 1 të nenit 43 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, merret masa urgjente si më poshtë: (shkronjat nga a-e të pikës 2 të nenit 43 përzgjidhen nga sistemi)

Kohëzgjatja e afatit të masës urgjente :

(ora, data e fillimit)

(ora, data e përfundimit)

Shënim:

Vendimi i ndërmjetëm përfundon automatikisht me kalimin e afatit të parashikuar në të dhe, kur nuk është përcaktuar një afat i tillë, me:

- a) njoftimin e revokimit të tij;
- b) njoftimin e përfundimit të procedimit apo njoftimin e vendimit përfundimtar, që nuk konstaton shkelje të kërkesave ligjore;
- c) skadimin e afatit për njoftimin e vendimit përfundimtar të inspektimit pa një vendim të tillë;
- d) njoftimin e vendimit të zgjidhjes së ankimit ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit në rastin kur është bërë ankimi;
- e) skadimin e afatit për paraqitjen e ankimit administrativ ndaj vendimit përfundimtar pa bërë ankimi;
- f) urdhërimin shprehimisht me vendim gjyqësor.

Inspektorët Vendor të autorizuar :

Inspektor 1 NUI (Nënshkrimi)

Inspektor 2 NUI (Nënshkrimi)

*Ky vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente njoftohet brenda 24 orëve.

*Kundër vendimit të masës urgjente, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm dhe nuk pezullon ekzekutimin e tij. Ankimi i veçantë paraqitet pranë Inspektoratit vendor përkatës.



Formati Nr. 5



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
INSPEKTORATI VENDOR

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____

Bazuar në nenin 46 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit nr. _____, datë ____/____/____, të zhvilluar në subjektin _____ prej datës ____/____/____ deri më datën ____/____/____.
(kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë ____/____/____ dhe e njoftoi në datë ____/____/____.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore (emërtesa e ligjit, nenit, pikës, germës të cilat merren nga procesverbali i inspektimit):

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit/ve nr. ____ nenit/eve ____ pikës ____ germës ____, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:
 - a. _____;
2. Dënim administrativ plotësues:
 - a. _____;
 - b. _____;

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive: (përzgjedhen nga sistemi)

Ngarkohet në sistem fleta shoqëruese e këshillimit me shkrim për subjektin për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. (sipas VKM përkatëse për marrjen e mostrave, me përzgjedhje nga sistemi)

Inspektorët Vendor të autorizuar :

Inspektor 1 NUI (Nënshkrimi)

Inspektor 2 NUI (Nënshkrimi)

Kundër Vendimit Përfundimtar të inspektimit, subjekti _____ ka të drejtën e ankimit brenda 1 muaji nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar.

Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror” të Inspektoratit Vendor të _____.

Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.



Formati Nr. 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
INSPEKTORATI VENDOR

**VENDIMI
PËR
ZGJIDHJEN E ANKIMIT TË VEÇANTË**

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____

(Emërtimi i inspektoratit vendor)

Në bazë të pikës 2 të nenit 44 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Ankimit të Veçantë nr. _____, datë _____, i subjektit _____ (emërtimi i subjektit që është ankuar), (kjo pjesa plotësohet nga sistemi)

Pasi shqyrtova ankesën e këtij subjekti dhe masën urgjente të marrë,

VENDOS:

1. Lënien në fuqi të vendimit të ndërmjetëm dhe rrëzimin e ankimit të veçantë ☐
2. Shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm dhe pranimin e ankimit të veçantë ☐
3. Ndryshimin e vendimit të ndërmjetëm, duke pranuar pjesërisht ankimin ☐

Për sa më sipër urdhëroj lënien në fuqi (nëse zgjidhet opsioni 1) / ndërprerjen (nëse zgjidhet opsioni 2) / ndryshimin (nëse zgjidhet opsioni 3) të masës urgjente përkatëse, (gjenerohet nga sistemi germat nga a) në e) të pikës 2 të nenit 43 të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”).

KRYEINSPEKTOR VENDOR

Nënshkrimi, Vula e institucionit

Kundër vendimit për zgjidhjen e ankimit të veçantë mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.



Formati Nr. 7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
INSPEKTORATI VENDOR

**AUTORIZIM PËR NDRYSHIMIN E
INSPEKTORËVE**

Nr. III/00000007/A

Datë ____/____/____

(Emërtimi i inspektoratit vendor)

Ndryshime në Autorizimin nr. ____, datë ____ (te gjenerohet nga sistemi autorizimi të cilit i referohet)

Baza ligjore: Neni 30, pika 3, e ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”.

Inspektori/ët vendor i autorizuar:

1. _____ NUI: _____

2. _____ NUI: _____

Zëvendësohen me Inspektorin/ët vendor i autorizuar:

1. _____ NUI: _____

2. _____ NUI: _____

Persona të tjerë të autorizuar :

1. _____

2. _____

Zëvendësohen me:

1. _____

2. _____

KRYEINSPEKTOR VENDOR

Nënshkrimi, Vula e institucionit

Autorizimi nuk mund të ankimohet veçmas vendimit përfundimtar të inspektimit.



Formati Nr. 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA
INSPEKTORATI VENDOR

**KËRKESË PËR REFUZIM TË
AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT**

Nr. III/00000007/A

Datë ____/____/____

Drejtuar: Z/Znj. _____
Kryeinspektor vendor (sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë)

Kërkesë për refuzim të Autorizimit nr. ____, datë _____ (plotësohet nga sistemi)

Bazuar në pikën 3, të nenit 30, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën Shqipërisë”, kërkohet refuzimi i Autorizimit nr. ____ datë ____, për arsye, si më poshtë:

1. Konflikt interesi
2. Programim në ...
3. Leje vjetore
4. Paaftësi e përkohshme
5. Etj.

Inspektori vendor:

Inspektor _____ NUI (Nënshkrimi)

Nënshkrimi, data



Formati Nr. 9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
INSPEKTORATI VENDOR

**KËRKESË PËR SHTYRJE TË
AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT**

Nr. III/00000007/A

Datë ____/____/____

Drejtuar: Z/Znj. _____
Kryeinspektor (sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë)

Kërkesë për shtyrje të Autorizimit nr. ____, datë _____

Bazuar në pikën 3, të nenit 29, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën Shqipërisë”, kërkohet shtyrje e kohëzgjatjes së inspektimit, për arsye, si më poshtë:

Kohëzgjatja e inspektimit shtyhet me: _____
(Me selektim në sistem: 1/2, 1 e 1/2 - 15 ditë)

(data e fillimit)_____
(data e përfundimit)

*Shënim: kohëzgjatja mund të shtyhet me një herë të vetme dhe për një periudhë jo më të madhe se kohëzgjatja fillestare.

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

Inspektorët vendor:

Inspektor 1 NUI (Nënshkrimi)

Inspektor 2 NUI (Nënshkrimi)

Vendimi i njoftohet subjektit të inspektimit përpara skadimit të kohëzgjatjes dhe nuk mund të ankimohet veçmas.



Formati Nr. 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
INSPEKTORATI VENDOR

**VENDIM PËR SHTYRJE TË
AUTORIZIMIT TË INSPEKTIMIT**

Nr. III/00000007/A

Datë

____/____/____

Bazuar në pikën 3, të nenit 29, të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH” dhe kërkesën nr ____ datë ____ (nga sistemi kërkesa e paraqitur nga inspektori vendor) autorizoj/nuk autorizoj shtyrjen e kohëzgjatjes së inspektimit, për arsye, si më poshtë:

Të dhëna mbi subjektin e inspektimit:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Përshkrim i objektit të inspektimit: (Sigurimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore.....)

Inspektorët vendor të autorizuar:

1. _____ NUI: _____

2. _____ NUI: _____

(Nëse jepet autorizim për shtyrje të afatit)

Kohëzgjatja e inspektimit shtyhet me (selektim në sistem) _____
(data e fillimit) (data e përfundimit)

Shënim: Kohëzgjatja mund të shtyhet me një herë të vetme dhe për një periudhë jo më të madhe se kohëzgjatja fillestare

Vendi/vendet e inspektimit (adresa/t): _____

KRYEINSPEKTOR VENDOR_____
Nënshkrimi, Vula e institucionit



Formati Nr. 11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
INSPEKTORATI VENDOR

VENDIMI

I KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKIMIT

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____

Emërtimi i Komisionit të Ankimit _____
(Emërtimi i inspektoratit vendor)Emri i subjektit që është ankuar të cilit i referohet vendimi përfundimtar *(kjo pjesa plotësohet nga sistemi)*Në bazë të pikës 2 të nenit 51 të ligjit 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Ankimit për vendimin përfundimtar nr. _____, datë ____/____/____, i subjektit _____ (emërtimi i subjektit që është ankuar), *(kjo pjesa plotësohet nga sistemi)*Pasi shqyrtoi ankesën e këtij subjekti dhe masën administrative të marrë *(Shpjegimi i fakteve që janë bërë shkak për vendosje të dënimit administrativ)*, Komisionit i ankimit:

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit përfundimtar dhe rrëzimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐
2. Shfuqizimin e vendimit përfundimtar dhe pranimin e ankimit për vendimin përfundimtar ☐
3. Ndryshimin e vendimit përfundimtar, duke pranuar pjesërisht ankimin për vendimin përfundimtar ☐

Për sa më sipër urdhëroj lënien në fuqi (nëse zgjidhet opsioni 1) / shfuqizimin (nëse zgjidhet opsioni 2) / ndryshimin (nëse zgjidhet opsioni 3) e vendimit përfundimtar përkatës, *(gjenerohet nga sistemi vendimi përfundimtar i inspektimit)*.

KRYETARI I KOMISIONIT TË ANKIMIT

*Nënshkrimi, Vula e institucionit**Kundër Vendimit të Komisionit të Ankimit mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit*



Formati Nr. 12



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
INSPEKTORATI VENDOR

ANKESË
PËR
VENDIMIN PËRFUNDIMTAR TË INSPEKTIMIT

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____

Drejtuar : Komisionit të Shqyrtimit të Ankimimit

(Emërtimi i Inspektoratit Vendor)

Subjekti ankues: (kjo pjesa plotësohet nga sistemi)

Objekti : Pavlefshmëri/ndryshimi i vendimit përfundimtar të inspektimit nr. _____ datë ____/____/____ (vjen nga sistemi nr. _____ datë ____/____/____ i vendimit përfundimtar të inspektimit që ankimohet).

Baza ligjore: neni 51 i Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

1. Faktet dhe shpjegimet në lidhje me to;

2. Baza ligjore e plotë (kjo pjesa plotësohet nga sistemi);
3. Shpjegime të qarta në lidhje me pretendimet.

Emri i plotë i ankuesit (kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Nënshkrimi

Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm, paraqitja e ankimit administrativ pezullon ekzekutimin e vendimit përfundimtar të ankimuar, por nuk cenon ekzekutimin e masave urgjente.



Formati Nr. 13



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA
INSPEKTORATI VENDOR

ANKIMI I VEÇANTË

Nr. III/00000007/VP

Datë ____/____/____

Drejtuar : Kryeinspektorit vendor

(Emërtimi i Inspektoratit Vendor)

Subjekti ankues: _____ (kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Objekti : Pavlefshmëria/ndryshimi i vendimit të ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente
nr. ____ datë ____/____/____ (vjen nga sistemi nr. datë i vendimit të ndërmjetëm që ankimohet).

Baza ligjore: neni 44 i Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

1. Faktet dhe shpjegimet në lidhje me to;

2. Baza ligjore e plotë (kjo pjesë plotësohet nga sistemi);
3. Shpjegime të qarta në lidhje me pretendimet.

Emri i plotë i ankuesit (kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Nënshkrimi

Ankimi i veçantë mund të paraqitet brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm dhe nuk pezullon ekzekutimin e tij.



URDHËR

Nr. 18, datë 23.6.2022

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË RREGULLOREN “PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË
INSPEKTIMEVE, SI NJË PROCES I
RREGULLT ADMINISTRATIV”,
MIRATUAR ME URDHËRIN NR. 25,
DATË 10.8.2018**

Në mbështetje të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 16.8.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik ‘e-Inspektimi’”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, miratuar me urdhrin nr. 25, datë 10.8.2018, e cila i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë integrale e tij.

2. Ngarkohen Inspektorati Qendror, inspektoratet shtetërore dhe trupat e tjera inspektuese në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare dhe publikohet i ndryshuar në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe i dërgohet për njoftim inspektorateve shtetërore dhe trupave të tjera inspektuese.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari**

URDHËR

Nr. 25, datë 10.8.2018

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
SË INSPEKTIMEVE, SI NJË PROCES I
RREGULLT ADMINISTRATIV”**

Në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; të nenit 16, pika 2, germa “c”, të vendimit nr. 696, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik ‘e-Inspektimi’”; të kreut III të rregullores “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të inspektimit ‘e-Inspektimi’” të ndryshuar; të urdhrit nr. 13, datë 23.4.2015, “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të vendimit të Zëvendëskryeministrit nr. 1, datë 12.10.2017, “Komitetit drejtues për ristrukturimin e institucioneve të varësisë” dhe akteve të tjera nënligjore,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Inspektorati Qendror, inspektoratet shtetërore dhe vendore, si dhe trupat e tjera inspektuese për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe iu njoftohet inspektorateve shtetërore dhe vendore, si dhe trupave të tjera inspektuese.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari**



RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË
INSPEKTIMEVE,
SI NJË PROCES I RREGULLT
ADMINISTRATIV

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i rregullore është përcaktimi i rregullave të hollësishme të ushtrimit të veprimtarisë inspektuese nga inspektoratet shtetërore dhe vendore, si dhe trupat e tjera inspektuese, sipas Kodit të Procedurave Administrative; ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjeve sektoriale, akteve nënligjore dhe rregullatore në fushën e inspektimit.

2. Kjo rregullore ka si objekt përcaktimin e rregullave për kryerjen e inspektimeve në territorin e vendit, si dhe në pikat e kalimit kufitar, bazuar në një procedurë administrative të rregullt ligjore, me qëllim rritjen e efektivitetit, përgjegjshmërisë, transparencës dhe shmangies së korrupsionit në fushën e veprimtarisë së inspektimeve, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm, të personave fizikë dhe juridikë që përfshin:

a) kryerjen e veprimtarisë inspektuese me dokumente standarde, listë verifikimi dhe kartën e inspektorit;

b) kryerjen e inspektimeve bazuar në metodologjinë e analizës së vlerësimit të riskut;

c) kryerjen e inspektimeve *online* në sistemin “*e-Inspektimi*” nëpërmjet pajisjes elektronike tabletë.

KREU II
PROCEDURA E INSPEKTIMIT

3. Inspektimi kryhet mbi bazën e një procedimi administrativ të përcaktuar nga Kodi i Procedurave Administrative, ligji nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi (*referuar paraqitjes skematike të procedurës së inspektimit në aneksin I*).

4. Formatet për dokumentimin e kryerjes së veprimtarisë së inspektimit, që duhet të përdoren nga inspektoratet shtetërore, janë të përcaktuara për inspektoratet shtetërore edhe në urdhrin nr. 58, datë 21.8.2014, “Për miratimin e formateve

standard për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe për inspektoratet vendore në urdhrin nr. 26, datë 7.3.2017, “Për miratimin e formateve standarde për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit në inspektoratet vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe gjenden në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror, si dhe në aneksin 1, të kësaj rregulloreje.

5. Procedura e inspektimit apo edhe riinspektimit, kryhen me tabletë *online* në sistemin e inspektimeve “*e-Inspektimi*”, në vendin ku subjekti kryen aktivitetet apo në pikat e kalimit kufitar për inspektoratet shtetërore që e kanë të përcaktuar në ligjin e posaçëm.

6. Të gjitha veprimet procedurale të inspektimit kryhen në praninë e subjektit apo përfaqësuesit ligjor të tij. Të gjitha provat dhe faktet për shpjegimin e rrethanave të dokumentuara nëpërmjet fotove dhe pamjeve audiovizive i bashkëngjiten çështjes përkatëse, të krijuar në sistemin *online* “*e-Inspektimi*”.

7. Inspektimet për nga forma e autorizimit dhe organizimit të tyre ndahen në:

a) inspektime të programuara;

b) inspektime jashtë programi.

Një procedurë inspektimi e rregullt administrative, e programuar apo jashtë programi, është paraqitur në formë skematike, si dhe në shtojcat 1 dhe 2, të kësaj rregulloreje.

8. Programi vjetor i inspektimit hartohet nga çdo inspektorat shtetëror, mbi bazë tematike, mbështetur në metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe në detyrimin për inspektim periodik, me qëllim planifikimin sasior të akteve të inspektimit dhe përcaktimin e tematikave të inspektimit përgjatë vitit kalendarik. Programi i hartuar, brenda datës 15 tetor të vitit paraardhës, i paraqitet për mendim këshillimor Inspektoratit Qendror.

9. Programi mujor i inspektimit hartohet mbi bazë subjektsh, në zbatim të fushave dhe prioriteteve të përcaktuara në programin vjetor të inspektimeve dhe i paraqitet për mendim këshillimor, brenda datës 15 të muajit paraardhës, Inspektoratit Qendror.

10. Programet vjetore dhe mujore të inspektimit, të hartuara nga çdo inspektorat shtetëror, pas marrjes së mendimit këshillimor nga Inspektorati Qendror, gjenerohen në sistemin “*e-*



Inspektimi”, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga dita e marrjes së përgjigjes.

11. Çdo subjekt, objekt inspektimi, inspektohet sipas programit mujor të inspektimit të miratuar. Përfshihet, një inspektim mund të autorizohet jashtë programit mujor të inspektimit, në rastet e përcaktuara në ligjin për inspektimin (*shih shtojcën 2*).

KREU III AUTORIZIMI I INSPEKTIMIT

12. Autorizimi i inspektimit i njoftohet subjektit, objekt inspektimi, nëpërmjet dorëzimit paraprak të njoftimit, *jo më vonë se 7 ditë* nga dita e përpilimit të aktit administrativ “autorizimi”, përpara fillimit të veprimtarisë inspektuese nga trupa inspektuese.

13. Mosnjoftimi paraprak i autorizimit kryhet për ato fusha inspektimi të cilat e kanë të parashikuar në ligjin e posaçëm. Arsyet e mosnjoftimit të parashikuara sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit për inspektimin, motivohen me shkrim nga Kryeinspektori në autorizimin e inspektimit.

14. Veprimet e inspektimit nga trupa inspektuese kryhen brenda kohëzgjatjes së parashikuar në autorizim.

15. Kërkesa për shtyrje autorizimi nga trupa inspektuese për rastet me kompleksitet të veprimeve inspektuese kryhet brenda afatit të përcaktuar në autorizim.

16. Vendimi për shtyrjen e autorizimit kryhet brenda kohëzgjatjes së parashikuar në autorizimin e mëparshëm dhe jo më shumë se kohëzgjatja fillestare.

KREU IV INSPEKTIMI ME URDHËR TË POSAÇËM

17. Kryeinspektori në nivel qendror mund të urdhërojë kryeinspektorin e një drejtorie rajonale të kryejë procedurë inspektimi të posaçëm, duke përcaktuar në urdhër kohën apo periudhën e kryerjes së inspektimit, fushën apo subjektin që do të inspektohet. Në urdhër duhet të pasqyrohet arsyeja, burimi i informacionit që është bërë shkak për kryerjen e inspektimit të posaçëm.

18. Kryeinspektori i drejtorisë rajonale mund të autorizojë kryerjen e një inspektimi të posaçëm dhe përcakton aktin administrativ në objektin e inspektimit. Shkaqet apo burimi i informacionit për

të cilin iniciohet veprimtaria inspektuese, bëhen pjesë e dosjes së inspektimit.

19. Inspektimi me urdhër të posaçëm kryhet:

a) sipas programit;

b) jashtë programi.

20. Inspektimi me urdhër të posaçëm kryhet sipas rastit të parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 18, në rastet kur urdhri parashikon një periudhë kohore për inspektim, e cila mund të paraqitet në programin e muajit paraardhës të inspektimeve.

21. Inspektimi me urdhër të posaçëm kryhet sipas rastit të parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 18, në rastet kur urdhri parashikon një kohëzgjatje inspektimi e cila nuk mund të paraqitet në programin e muajit paraardhës të inspektimeve.

22. Autorizimi për kryerjen e inspektimit me urdhër të posaçëm përmban elementet e parashikuara në ligjin për inspektimin, si dhe gjeneralitetet e inspektorëve me numrin e identifikimit të kartës së inspektorit.

23. Autorizimi dhe e gjithë procedura e inspektimit të posaçëm, në zbatim të urdhrit të kryeinspektorit në nivel qendror, kryhet nga kryeinspektori i drejtorisë rajonale, ku do të realizohet procedura e inspektimit, sipas fazave dhe përpilimit të dokumenteve të pasqyruara në shtojcat e kësaj rregulloreje (*procedura jashtë programit dhe sipas programit është e detajuar në shtojcën 1 dhe 2*).

24. Kryeinspektori në nivel qendror, vetëm me urdhër të posaçëm, mund të urdhërojë kryeinspektorin e drejtorisë rajonale që të përfshijë për mbështetje gjatë procedurës së inspektimit të posaçëm edhe inspektorë të nivelit qendror apo të një drejtorie tjetër rajonale, duke përcaktuar emrat e tyre në urdhër.

KREU V LISTA E VERIFIKIMIT

25. Lista e verifikimit hartohet nga inspektoratet shtetërore dhe vendore, si dhe trupat e tjera inspektuese, me mbështetje metodologjike të Inspektoratit Qendror, mbi bazën e kërkesave të ligjit për inspektimin dhe legjislacionit të posaçëm, të fushës përkatëse të inspektimit.

26. Lista e verifikimit plotësohet nga trupa inspektuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, pranë subjektit të inspektimit dhe nënshkruhet nga trupa inspektuese dhe subjekti.



KREU VI MBAJTJA E PROCESVERBALIT

27. Pas plotësimit dhe mbylljes së listës së verifikimit, trupa inspektuese plotëson procesverbalin e inspektimit duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin e shqyrtuar.

28. Procesverbali i inspektimit përmban informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo në mënyrë verbale shpjegimet apo kontestimet e tij për fakte, rrethana dhe gjetjet e pasqyruara në procesverbal sipas ligjit për inspektimin.

29. Kur subjekti i inspektimit nuk ka për të dhënë shpjegime apo kontestime për gjetjet e pasqyruara në procesverbal, trupa inspektuese merr vendim përfundimtar, aty për aty, për rastet e parashikuara në ligjin e posaçëm.

30. Kur në procesverbal nuk konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, por trupa inspektuese e gjykon të nevojshme, këshillon apo rekomandon subjektin e inspektimit duke e pasqyruar një fakt të tillë në procesverbal për parandalimin në të ardhmen, për shkeljen e mundshme të kërkesave ligjore.

KREU VII KORRIGJIMI DHE NDJEKJA E SHKELJEVE TË LËNA NGA INSPEKTIMI

31. Subjekti i inspektimit për rastet kur ka shkelje të kërkesave ligjore urdhërohet t'i korrigjojë ato, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar përfshin këshillimin apo rekomandimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve dhe afatet kohore.

32. Subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve, brenda afatit të përcaktuar nga trupa inspektuese, në vendimin përfundimtar të inspektimit të mëparshëm dhe nëse është e nevojshme të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.

33. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara nga trupa inspektuese mund të kryhet riinspektim. Në rastet kur nga riinspektimi rezulton se subjekti nuk ka zbatuar detyrat e lëna nga inspektimi i mëparshëm, procedohet me masë administrative.

KREU VIII MARRJA E MOSTRAVE

34. Trupa inspektuese e inspektorateve shtetërore dhe vendore, si dhe trupat e tjera inspektuese ka të drejtë të marrë pa pagesë mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve dhe t'ia nënshtrojë ato ekzaminimit apo analizave.

35. Mostrat merren në prani të përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, përveç rasteve kur ai është përjashtuar me vendim të pasqyruar në procesverbal, nga të qenit i pranishëm gjatë procedurës së inspektimit. Përpara zgjedhjes së mostrave, trupa inspektuese i shpjegon përfaqësuesit të subjektit mënyrën e marrjes së tyre.

36. Gjatë inspektimit, trupa inspektuese argumenton në procesverbalin e inspektimit arsyen e kryerjes së ekzaminimeve të mëtejshme dokumentare apo marrjen e mostrave për analizë.

37. Mostrat për analizë merren:

a) sipas planit të marrjes së mostrave bazuar në ligjin e posaçëm referuar metodologjisë së vlerësimit të riskut;

b) për rastet kur trupa inspektuese ka dyshim për shkelje të kërkesave ligjore.

38. Trupa inspektuese, për rastin e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 37, procedon me mbylljen e procesverbalit dhe vendimit përfundimtar në vendin e inspektimit. Nëse rezultati i ekzaminimit do të rezultojë “*jokonform*”, trupa inspektuese inicion riinspektim me objekt inspektimi: “*riinspektim për rezultat ‘jokonform’ të mostrave të analizuarra sipas planit të marrjes së mostrave*”.

39. Trupa inspektuese për rastin sipas shkronjës “b”, të pikës 37 e mbyll procesverbalin. Vendimi përfundimtar merret menjëherë pas marrjes së rezultatit të ekzaminimit të mostrës duke përfunduar vendimin e ndërmjetëm.

40. Dokumenti me rezultatet “*konform*” apo “*jokonform*” të mostrave të ekzaminuara duhet të bashkëngjitet në sistemin “*e-Inspektimi*”, në dosjen për çështjen përkatëse.

KREU IX MARRJA E VENDIMIT TË NDËRMJETËM

41. Masa urgjente merret nga trupa inspektuese gjatë inspektimit, me vendim të ndërmjetëm kur:



a) për shkak të shkeljes së konstatuar të kërkesave ligjore mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm i interesit publik apo i palëve të treta, veçanërisht kur është e nevojshme për të shmangur një rrezik të menjëhershëm për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve a për mjedisin;

b) ka një dyshim të arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore, nga e cila mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm, i interesit publik apo i palëve të treta dhe është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme dokumentare ose kryerja e ekzaminimeve apo marrja e mostrave për analizë.

42. Vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente pasqyrohet në procesverbal dhe i njoftohet subjektit pa vonesë në mënyrë verbale, ndërkohë që një akt i shkruar me të njëjtën përmbajtje njoftohet me shkrim brenda 24 orëve. Masat urgjente mund të merren deri në çastin e marrjes së vendimit përfundimtar.

43. Vendimi i ndërmjetëm përfundon sipas parashikimeve të përcaktuara në ligjin për inspektimin.

44. Kundër vendimit të ndërmjetëm, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë tek organi kompetent, i cili ka lëshuar aktin administrativ. Trupa inspektuese, verbalisht dhe në akt, i njofton subjektin të drejtën e ankimimit të veçantë brenda 5 ditëve, nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të ndërmjetëm.

45. Ankimi i veçantë është pjesë e procedurave të ankimit administrativ të inspektimit dhe e drejtë për t'u ushtruar nga subjekti gjatë procedurës së inspektimit, në rastet kur trupa inspektuese ka marrë masë urgjente. Kundër vendimit të masës urgjente, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë, i cili mund të paraqitet brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm, duke iu drejtuar me shkrim kryeinspektorit të drejtorisë rajonale dhe për inspektoratet e qendëruara, kryeinspektorit të inspektoratit shtetëror.

46. Ankimi i veçantë i subjektit dhe dokumentacioni i mbajtur për shqyrtimin, si dhe vendimi përfundimtar për zgjidhjen e tij ngarkohen në sistemin “e-Inspektimi”, në çështjen përkatëse sipas rregullave “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të inspektimit ‘e-Inspektimi’”, i ndryshuar.

KREU X

MARRJA E VENDIMIT PËRFUNDIMTAR

47. Në rastet kur nuk janë konstatuar shkelje, vendimi përfundimtar i inspektimit është pjesë e procesverbalit të inspektimit dhe nënshkruhet në tabletë nga trupa e inspektimit dhe përfaqësuesi i subjektit të inspektuar në vendin ku është kryer inspektimi.

48. Në rastet kur janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore gjatë procedurës së inspektimit ose riinspektimit, trupa inspektuese mbyll procesverbalin dhe merr vendim përfundimtar aty për aty, për rastet e parashikuara në ligjet sektoriale.

49. Procesverbali dhe vendimi përfundimtar mbahen nga trupa e inspektimit në vendin e inspektimit dhe nënshkruhen në tabletë nga trupa inspektuese dhe subjekti.

50. Trupa inspektuese njofton procesverbalin e inspektimit dhe vendimin përfundimtar brenda 24 orëve, nëpërmjet dorëzimit personal ose me postë në adresën e subjektit të inspektuar. Brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i procesverbalit të inspektimit dhe vendimit përfundimtar, subjekti ka të drejtë të ankohet me shkrim kundër vendimit përfundimtar te Komisioni të Shqyrtimit të Ankimeve pranë inspektoratit përkatës.

51. Komisioni i Shqyrtimit të Ankimit shqyrton ankimin, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit, por jo më vonë se 30 ditë nga data e nënshkrimit të procesverbalit dhe vendimit përfundimtar. Shqyrtimi i ankimit detyrimisht kryhet në prani të subjektit ankimes. Njoftimi i subjektit për datën dhe vendin e shqyrtimit të ankimit të tij, bëhet sipas procedurës së pasqyruar në kolonën 3, të shtojcës 1, të kësaj rregulloreje. Krijimi dhe funksionimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve përcaktohet sipas ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjeve sektoriale. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve është i formës së prerë dhe mund të ankimohet vetëm në gjykatë.

52. Të gjitha etapat e dokumentuara gjatë shqyrtimit të procedurës së ankimit nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankimit ngarkohen në sistemin online “e-Inspektimi”, nga sekretari dhe juristi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit.



KREU XI PROCEDURA E ANKIMIT NË GJYKATË

53. *Kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve*, që është vendim përfundimtar, subjekti ka të drejtë që brenda 45 ditëve të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

54. Vendimi i Gjykatës Administrative ngarkohet në sistemin online “*e-Inspektimi*”, sipas rregullores “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të inspektimit ‘*e-Inspektimi*’”, i ndryshuar.

KREU XII PËRDORUESIT E AUTORIZUAR TË PORTALIT

55. Çdo procedurë administrative që ka të bëjë me funksionet inspektuese duhet të pasqyrohet nga përdoruesit e autorizuar të portalit në sistemin elektronik të inspektimeve “*e-Inspektimi*”, referuar nenit 11, të rregullores “Për përcaktimin e procedurave dhe mënyrave për përdorimin e portalit unik të inspektimit ‘*e-Inspektimi*’”, i ndryshuar.

56. Përdoruesit e autorizuar mbajnë përgjegjësi për respektimin e afateve kohore dhe procedurave,

të përcaktuara për t'u bërë me mjete elektronike në portal, sipas ligjit nr. 10433/2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit nr. 696, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik ‘*e-Inspektimi*’”, si dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

KREU XIII DISPOZITA TË FUNDIT

57. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha trupat inspektuese, inspektoratet shtetërore dhe inspektoratet vendore në Republikën e Shqipërisë. Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje sjell përgjegjësi administrative dhe penale.

58. Ngarkohen Inspektorati Qendror, inspektoratet shtetërore dhe vendore, si dhe trupat e tjera inspektuese për zbatimin e kësaj rregulloreje.

KREU XIV HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA 1

PROCEDURA ADMINISTRATIVE E INSPEKTIMIT TË PROGRAMUAR						
1	2	3	4	5	6	7
Procedura administrative e inspektimit autorizohet nëpërmjet portalit unik të inspektimit, plotësohet në të gjitha rubrikat dhe nënshkruhet dhe vultet, si akt administrativ i vlefshëm ligjor sipas formatit të miratuar nga Inspektorati Qendror.	Autorizimi printohet në dy kopje, nënshkruhet dhe vultet nga kryeinspektori. Autorizimi i inspektimit i njoftohet subjektit, objekt inspektimit, nëpërmjet dorëzimit paraprak të njoftimit. Jo më vonë se 7 ditë , nga dita e përpilimit të veprimtarisë inspektuese nga trupa inspektuese.	Dokumentimi i marrjes së njoftimit paraprak të autorizimit nga subjekti për kryerjen e inspektimit, kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nëpërmjet dorëzimit personal, përfaqësuesit të subjektit objekt inspektimi, të kopjes së autorizimit. Subjekti nënshkruan për marrjen në dijeni tek kopja e autorizimit të trupës inspektuese.	Në rast të refuzimit të marrjes së autorizimit apo mosgjatjes së personit përfaqësues të subjektit, personi përgjegjës e afishon autorizimin në vendin ku do kryhet inspektimi dhe ky fakt pasqyrohet në kopjen e autorizimit të trupës inspektuese si dhe në çështjen përkatëse.	Veprimtaria inspektuese realizohet në përputhje me kohëzgjatjen e përcaktuar në autorizim procedural i kryer jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim, nuk prodhon asnjë pasojë juridike për subjektin e inspektimit dhe ngarkon me përgjegjësi disiplinore trupën inspektuese përkatëse.	Procesverbal i inspektimit dhe Vendimi Përfundimtar bazohen në gjetjet e konstatuara në Listën e Verifikimit, e cila gjatë inspektimit plotësohet në të gjitha rubrikat. Procesverbal i inspektimit dhe Vendimi Përfundimtar nënshkruhen nga trupa e inspektimit dhe nga përfaqësuesi i subjektit objekt inspektimi, në vendin ku kryhet inspektimi.	a) Procesverbal i inspektimit plotësohet në të gjitha rubrikat nga trupa inspektuese dhe mban informacion të hollësishëm për veprimet procedurale, gjetjet e konstatuara nga Lista e Verifikimit dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe i njoftohet, pa vonesë, subjektit të inspektimit. Trupa inspektuese duhet të pasqyrojë në procesverbal pretendimet, kontestimet e subjektit objekt inspektimi mbi gjetjet e konstatuara, përpara se të marr vendimin përfundimtar. b) Procesverbal i inspektimit dhe vendimi përfundimtar mbahen në prani të subjektit në vendin ku kryhet inspektimi dhe nënshkruhen në tabelë nga trupa inspektuese dhe përfaqësuesi i subjektit, në përfundim të veprimtarisë inspektuese. c) Procesverbal i inspektimit dhe Vendimi Përfundimtar i njoftohen subjektit nëpërmjet dorëzimit personal ose postës. d) Nëse subjekti nuk bie dakord për nënshkrimin e Procesverbalit dhe Vendimit Përfundimtar, kjo pasqyrohet nga trupa inspektuese me shënimin “Refuzon firmën” dhe brenda 24 orëve Procesverbal dhe Vendimi Përfundimtar i dërgohen subjektit të inspektuar me postë në adresën e tij duke patur të njëjtën fuqi juridike si të jenë nënshkruar rregullisht nga ai. e) Brenda 15 ditëve nga nënshkrimi ose dërgimi me postë i Procesverbalit dhe Vendimit Përfundimtar subjektit i lind e drejta e ankimit të këtij vendimi në Komisionin e Shqyrtimit të Ankimeve, të ngritur pranë Inspektoratit Shtetëror. Brenda 15 ditëve nga dita e depozitimit të ankimit të subjektit, por jo më vonë se 30 ditë Komisioni shqyrton ankimin dhe merr vendimin. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve është vendim përfundimtar. f) KUNDËR VENDIMIT TË KOMISIONIT TË SHQYRTIMIT TË ANKIMEVE, që është vendim përfundimtar, subjekti ka të drejtë që brenda 45 ditëve të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, bazuar në Ligjin nr. 10433/2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe Kodin e Procedurave Administrative.
8						
Autorizimi, marrja e njoftimit të autorizimit, Listë Verifikimi, Procesverbal Inspektimi dhe Vendimi Përfundimtar, dokumentacioni justifikues, marrja e njoftimit të procesverbalit, shpërgjimet apo kontestimet e subjektit mbi gjetjet e konstatuara në procesverbal, marrja e njoftimit të vendimit përfundimtar, përgjigjet e rezultateve të ekzaminimeve, analizave, dhe çdo dokument tjetër i administruar në dosjen e inspektimit (prova materiale, fotografime, filmime, regjistrime), të nënshkruara dhe vultura, ngarkohen në sistemin online “e-Inspektimi”, në dosjen përkatëse.						



SHTOJCA 2

PROCEDURA ADMINISTRATIVE E INSPEKTIMEVE JASHTË PROGRAMIT				
1	2	4	5	6
Inspektim jashtë programit konsiderohet inspektim: a) në kushtet e flagrancës, b) në rastin e ndodhjes së ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve, c) denoncime që kanë cënuar apo mund të cënojnë jetën a shëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin. d) për rastin e parashikuar në shkronjën a), të pikës 18, të kreut IV, të kësaj rregulloreje.	Inspektimi fillon pa autorizim, në rastet e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2, të nenit 27, të ligjit për inspektimin, kjo pasqyrohet, pa vonesë, me një shënim në rubrikën e posaçme të procesverbalit të inspektimit dhe konsiderohet, si autorizim i posaçëm. Inspektori duhet të njoftojë, pa vonesë nëpunësin përgjegjës për lëshimin e autorizimit të inspektimit. Për Inspektimin në Pikat e Kalimit Kufitar Inspektimi fillon pa autorizim dhe nuk është në kushtin e parashikuar në pikën 3 të nenit 27, të ligjit për inspektimin.	Autorizimi, i gjeneruar nga portali unik i inspektimit plotësohet, nënshkruhet dhe vulozet si akt administrativ i vlefshëm ligjor sipas formatit të miratuar nga Inspektorati Qendror.	Inspektimi i realizuar jashtë programit duhet të argumentohet në autorizim dhe dokumentohet në dosjen e inspektimit për arsyen e fillimit të inspektimit jashtë programit.	Pikat “6”, “7”, të parashikuara në Shtojcën 1 të kësaj rregulloreje zbatohen edhe për procedurën e inspektimit jashtë programit.
Autorizimi, marrja e njoftimit të autorizimit, listë verifikimi, procesverbal inspektimi, dokumentacioni justifikues, marrja e njoftimit të procesverbalit, shpjegimet apo kontestimet e subjektit mbi gjetjet e konstatuara në procesverbal, marrja e njoftimit të vendimit përfundimtarë, përgjigjet e rezultatit të analizave, dhe çdo dokument tjetër i administruar në dosjen e inspektimit (prova material, fotografime, filmime), i nënshkruar dhe vulozor, ngarkohen në portal, në dosjen përkatëse.				

ANEKS I

DOKUMENTET E INSPEKTIMIT, PARAQITJA SKEMATIKE E PROCEDURËS SË INSPEKTIMIT DHE KARTA E INSPEKTORIT

Më poshtë gjenden formatet standarde për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit të inspektorateve shtetërore dhe vendore në Republikën e Shqipërisë:

Për inspektoratet shtetërore:

1. Autorizim inspektimi;
2. Listë verifikimi;
3. Procesverbal inspektimi;
4. Vendim i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente;
5. Vendim përfundimtar i inspektimit;
6. Vendim për zgjidhjen e ankimit të veçantë;
7. Autorizim për ndryshimin e inspektorëve;
8. Kërkesë për refuzim të autorizimit të inspektimit;
9. Kërkesë për shtyrje të autorizimit të inspektimit;
10. Vendim për shtyrje të autorizimit të inspektimit;
11. Vendim i Komisionit të Ankimit;

12. Ankesë për vendimin përfundimtar të inspektimit;

13. Ankimi i veçantë.

Për inspektoratet vendore:

1. Autorizim inspektimi;
2. Listë verifikimi;
3. Procesverbal inspektimi;
4. Vendim i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente;
5. Vendim përfundimtar i inspektimit;
6. Vendim për zgjidhjen e ankimit të veçantë;
7. Autorizim për zëvendësim inspektori vendor;
8. Kërkesë për refuzim të autorizimit të inspektimit;
9. Kërkesë për shtyrje të autorizimit të inspektimit;
10. Vendim për shtyrje të autorizimit të inspektimit;
11. Vendim i Komisionit të Ankimit;
12. Ankesë për vendimin përfundimtar të inspektimit;
13. Ankimi i veçantë.

1. Paraqitje skematike e procedurës së inspektimit

2. Karta e inspektorit



**FORMATET STANDARDE PËR DOKUMENTIMIN E VEPRIMTARISË
SË INSPEKTIMIT PËR INSPEKTORATET SHTETËRORE**

Formati Nr. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX
DREJTORIA RAJONALE _____

AUTORIZIM INSPEKTIMI

Nr. III/00000007/A

Datë ____/____/____

Bazuar në nenin 27, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM-së për krijimin e inspektoratit shtetëror përkatës autorizoj inspektimin e
Të dhëna mbi subjektin e inspektimit:

Emri i subjektit: _____ NIPT: _____

Adresa/vendndodhja: _____

Përshkrim i objektit të inspektimit: (Sigurimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore.....)

Inspektorët shtetërorë të autorizuar për të kryer inspektimin:

1. _____ NUI: _____

2. _____ NUI: _____

si dhe persona të tjerë të autorizuar:

1. _____ NUI: _____

2. _____ NUI: _____

Kohëzgjatja e inspektimit: _____

(Me selektim në sistem: 1/2, 1 e ½ –15 ditë)

(ora, data e fillimit)

(ora, data e përfundimit)

Vendi/vendet ku do të kryhet inspektimi (adresa/t): _____

Njoftim paraprak i autorizimit subjektit të inspektimit: Po ☐ Jo ☐

Njoftimi paraprak i autorizimit nuk njoftohet për arsye: (neni 32, pika 2, shkronjat “a”–“d”, gjenerohet nga sistemi. Në rastin e shkronjës “a”, vendimi i mosnjoftimit paraprak motivohet, ndërsa në rastin e shkronjës “b”, evidentohet përcaktimi i ligjit të posaçëm që lejon mosnjoftimin paraprak të inspektimit)” _____

KRYEINSPEKTORI

(sipas VKM-së për krijimin e ISH-së)

Nënshkrimi, vula e institucionit



Formati Nr. 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA XXX
INSPEKTORATI SHTETËROR XXX
 DREJTORIA RAJONALE _____

Nr. III/00000007/LV

Datë ____/____/____

LISTË VERIFIKIMI**Për** _____

Subjekti: _____ Nr. NIPT _____

Adresa: _____

Administratori: _____

Tel/Cel: _____ Fax: _____ E-mail: _____

Lloji Aktivitetit: _____

Emri i Subjektit	
vendimin nr. 00-2017-520 (130), datë 15.3.2017,



Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 10-2013-1822 (827), datë 25.11.2013 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, duke arsyetuar, ndër të tjera, se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës ishte dhënë nga një gjykatë jo kompetente, pasi me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012 mosmarrëveshjet e këtij lloji nuk gjykohen më nga gjykatat e apelit të organizuara në rrethe, por nga Gjykata Administrative e Apelit. Në këto kushte, Gjykata e Apelit Durrës duhet të kishte shpallur moskompetencën e saj lëndore për gjykimin e çështjes.

8. Pas vendimit të lartpërmendur të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31003-02340-86-2017 regj.them., datë 11.5.2017.

9. Në datën 8.7.2019, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë me objekt: *“Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm të parashikuar në shëronjën “a” të nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile, të vendimit të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë nr. 00-2017-520 (130), datë 15.3.2017, që ka vendosur prishjen e vendimit nr. 827, datë 25.11.2013, të Gjykatës së Apelit Durrës e dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe detyrimin e kësaj gjykate për përsheptimin e gjykimit të çështjes.”*

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 8/14/6, datë 17.6.2021, ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë, pasi nuk ka konstatuar zvarritje të qëllimshme të çështjes nga gjyqtari relator. Ndër të tjera, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se vonesa e gjatë në shqyrtimin e çështjes ishte rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalonte rastin konkret dhe se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh, duke krijuar kosto për qytetarët në tejzgjatjen e afateve për gjykimin e çështjeve gjyqësore, por që këto vështirësi janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme të krijuar nga procesi i reformës. Parimi i gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nuk duhet të keqkuptohet, pasi shpejtësia e kryerjes së veprimeve procedurale nuk e përjashton, përkundrazi e nënkupton kryerjen me cilësi të këtyre veprimeve të gjykatës. Në asnjë rast cilësia e procesit të rregullt ligjor dhe e

vendimmarrjes së gjykatës nuk duhet të sakrifikohet për *“sasinë e afatit të arsyeshëm”* ose edhe për ekonominë gjyqësore në tërësi (*shih paragrafët 22, 26 dhe 27, të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

11. Në datën 16.11.2021 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke kërkuar, në thelb, konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm, si dhe shfuqizimin e vendimit nr. 8/14/6, datë 17.6.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

12. Me vendimin e datës 23.12.2021, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 3.2.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. **Kërkuesja**, shoqëria “Elgakoti” sh.p.k., në kërkesën drejtuar Gjykatës ka pretenduar, në mënyrë të përmbledhur, se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

13.1 *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka shqyrtuar ende çështjen e saj të regjistruar në datën 11.5.2017, ndonëse është tejkaluar afati i parashikuar në nenin 48 të ligjit nr. 49/2012. Po kështu, kërkesa e saj për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave është gjykuar nga Gjykata e Lartë tej afatit 45-ditor, të parashikuar nga neni 399/7, pika 2, i KPC-së.

13.2 *E drejta e aksesit*, pasi gjykatat nuk kanë zgjidhur ende në themel çështjen e saj.

13.3 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykatat nuk kanë dhënë vendime brenda afateve të përcaktuara nga ligjet përkatëse.

13.4 *E drejta për dëmshpërblim*, pasi rivendosja e së drejtës së saj të shkelur mund të bëhet vetëm përmes dëmshpërblimit dhe kthimit të çështjes për rigjykim.

14. **Subjekti i interesuar**, Bashkia Elbasan, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuës

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuësja, në thelb, pretendon gjykimin përtej afatit të arsyeshëm të çështjes të saj në Gjykatën Administrative të Apelit, i cili ende nuk ka përfunduar, duke kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka rrëzuar kërkesën e saj për përshpejtimin e procedurave.

17. Për rrjedhojë, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor që ajo kundërshton dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

18. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë me shterimin e mjeteve juridike efektive. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuësja, e cila para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Për plotësimin e këtij kriteri kërkuësja duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të

përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike efektive, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*ligji nr. 38/2017*), Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe se individit duhet t’i shfrytëzojë ato përpara se t’i drejtohet asaj (*shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, duke qenë këto mjete të reja, si dhe duke pasur parasysh qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) për çështje të kësaj natyre, Gjykata e ka konsideruar të shteruar këtë kriter si në rastet kur Gjykata e Lartë është shprehur me vendim (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*), ashtu edhe në rastet e mungesës së një vendimi të saj (*shih vendimet nr. 39, datë 9.12.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se sipas shkresës nr. 827/1, datë 26.5.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit, kërkuësja nuk ka paraqitur kërkesë para asaj gjykate për përshpejtimin e gjykimit të çështjes sipas nenit 460, pika 3, të KPC-së, por i është drejtuar Gjykatës së Lartë në përputhje me nenet 399/1 e vijues të këtij kodi. Me vendimin nr. 8/14/6, datë 17.6.2021, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuësës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave.

21. Gjykata vëren se, në thelb, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive të gjyqtarit relator, por për shkak të ngarkesës, akumulimit të çështjeve dhe



shkurtimit të numrit të gjyqtarëve në sistem, pasoja këto të reformës në drejtësi (*shih paragrafët 21–26 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

22. Në këto kushte, Gjykata vëren se kërkesja e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000.¹

23. Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 17.6.2021, i është komunikuar asaj në datën 16.7.2021, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 16.11.2021, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

24. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se, edhe pse jo në objekt të kërkesës, kërkesja ka kërkuar dëmshpërblim si mjet për riparimin e cenimit të shkaktuar për shkak të mosshqyrtimit të çështjes së saj brenda afatit nga Gjykata e Lartë. Sipas saj, vendimi për kërkesën për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e gjykimit të çështjes është dhënë nga Gjykata e Lartë pas rreth 1 viti e 11 muajve, në kundërshtim me nenin 399/7, pika 2, të KPC-së që parashikon afatin 45-ditor për shqyrtimin e saj.

25. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata thekson se, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, ai nuk bën pjesë në juridiksionin e saj, prandaj kërkesja nuk legjitimohet *ratione materiae* në këtë drejtim.

26. Gjykata, gjithashtu, konstaton se objekt i ankimit kushtetues individual është ecuria e gjykimit që lidhet me kundërshtimin nga kërkesja të detyrimeve tatimore të vendosura ndaj saj nga Bashkia Elbasan, gjykim i cili është duke u zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se, në vështrim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit të themelit përfshihet në juridiksionin kushtetues, prandaj në vijim do të analizojë bazueshmërinë e tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

27. Kërkesja pretendon se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

28. Gjykata rithekson se e drejta për proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës dhe se kjo e drejtë luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (*shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se pas kthimit për rigjykim nga Gjykata e Lartë, çështja e kërkeses është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 11.5.2017 dhe ndonëse kanë kaluar mbi 5 vjet, kërkesja ende nuk ka një vendimmarrje për çështjen e saj.

31. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata sjell në vëmendje se neni 48 i ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”), që zgjatet edhe me 6 muaj të tjerë në rastin kur çështjet gjyqësore janë ende në proces gjykimi në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve (neni 109 i ligjit nr. 38/2017).

32. Kërkesja ka pretenduar para Gjykatës se në gjykimin e çështjes së saj nuk janë respektuar afatet ligjore, duke u zgjatur në mënyrë të paarsyeshme dhe se, referuar jurisprudencës kushtetuese, vonesa nuk mund të justifikohet nga

¹ 1 Gjyqtarët A. Binaj dhe P.Kalo votuan kundër legjitimitetit të kërkeses për shkak të mosshqyrtimit të mjetit juridik të parashikuar në nenin 460, pika 3, të KPC-së



numri i lartë i çështjeve që kanë në shqyrtim gjykatat administrative. Duke konsideruar afatet ligjore në raport me kohëzgjatjen e çështjes së kërkuases, çështje e cila ka qenë në proces në kohën e hyrjes në fuqi të ndryshimeve të KPC-së, Gjykata vlerëson se *prima facie* gjykimi i çështjes konkrete në Gjykatën Administrative të Apelit është tejzgjatur.

33. Në jurisprudencën e Gjykatës, fillimisht, kërkesat për ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm janë vlerësuar nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke mbajtur në konsideratë sjelljen e kërkuases, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 6, datë 31.3.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Në vijim, Gjykata, gjatë shqyrtimit të kërkesave për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se për të vlerësuar arsyeshmërinë e zgjatjes së procesit, përveç kriterëve të lartpërmendura, duhet të konsiderohet edhe rreziku që sjell për kërkuuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Këto kritere, nën dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së, u pasqyruan edhe në jurisprudencën e Gjykatës, kur shqyrtoi gjykimin brenda një afati të arsyeshëm pas hyrjes në fuqi të rregullave të reja të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së (*shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 34, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*), e cila kontrolloi edhe kriterin “*çfarë përbën rrezik*” për kërkuuesin.

34. Në këtë këndvështrim, në vijim Gjykata do të analizojë këto kritere në rastin konkret duke pasur parasysh sidomos: i) sjelljen e kërkuases; ii) kompleksitetin e çështjes; iii) sjelljen e autoriteteve; iv) si dhe çfarë përbën rrezik për kërkuuesin.

i. Sjellja e kërkuases

35. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes së kërkuessit është element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit, duke analizuar rrethanat nëse kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse ai është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim. Sjellja e kërkuessve përbën një faktor objektiv që duhet të merret parasysh për vlerësimin nëse është tejkaluar

koha e arsyeshme, sipas kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se kërkuessa ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes, madje edhe pse nuk i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, sipas nenit 460, pika 3, të KPC-së, ajo i është drejtuar Gjykatës së Lartë në datën 8.7.2019 me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave, sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së.

ii. Kompleksiteti i çështjes

37. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, sepse balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, që rregullohet nga ligji nr. 49/2012. Gjykimi në shkallën e parë është zhvilluar në mungesë të palëve dhe, krahas kërkuases, në gjykim është thirrur, si subjekt i paditur, Bashkia Elbasan. Po kështu, Gjykata konstaton se procedurat në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan kanë zgjatur rreth 3 muaj e gjysmë, në Gjykatën e Apelit Durrës 2 vjet e 11 muaj, në Gjykatën e Lartë rreth 3 vjet e 3 muaj dhe se Gjykata Administrative e Apelit është vënë në lëvizje përmes vendimit të Gjykatës së Lartë që i ka dërguar çështjen për rigjykim. Në thelb, çështja e kërkuases, aktualisht në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, ka të bëjë me ankimin ndaj një vendimi për pushimin e gjykimit.

39. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se relator i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit është caktuar fillimisht gjyqtari A.L., i cili nuk ushtron më funksionin e tij në këtë gjykatë. Në vijim, çështja i ka kaluar gjyqtarës E.M. dhe deri në datën e zhvillimit të seancës plenare nga



Gjykata Kushtetuese, për çështjen nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera procedurale, si njoftimi i palëve për paraqitjen e parashtrimeve shtesë, caktimi i seancës ose marrja e provave.

40. Për sa më lart, Gjykata çmon se kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë vonesat kohore në gjykimin e saj në Gjykatën Administrative të Apelit.

iii. Shpjegimi i autoriteteve

41. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimin brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e çështjeve brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Hyrja në fuqi e një ligji kushtëzon hyrjen në fuqi të normave të prodhuara prej tij, ose e thënë ndryshe, zbatueshmërinë e tyre nga ana e të gjitha organeve, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Në të kundërt është detyrë e ligjvënësit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 39, datë 9.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave, Gjykata vijon të mbajë një qasje më të kujdesshme, duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar. Megjithatë, ajo ka theksuar se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, në rast se ka ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të tillë.

Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përshejtimin e gjykimin të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e tillë rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme (*shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 34, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se gjykimi administrativ i ankimit të kërkuar vazhdon prej më shumë se 5 vjetësh pa vendimmarrje në shkallë të dytë, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar afate procedurale konkrete në ligjin nr. 49/2012 (*shih paragrafin 31 të vendimit*).

44. Duke marrë në konsideratë numrin aktual të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit, i cili është ulur në 6, si dhe numrin e lartë prej 15.157 çështjesh për shqyrtim prej saj (*shih raportin e KLGJ-së mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2021, faqja 63*), për qëllime të shqyrtimit kushtetues të çështjes, në seancën plenare të datës 26.5.2022, Gjykata vlerësoi të merrte informacion nga ajo gjykatë për ngarkesën e gjyqtarit relator, të cilit i është caktuar për shqyrtim çështja e kërkuar. Me shkresën nr. 827/1 prot., datë 26.5.2022, Gjykata Administrative e Apelit ka informuar Gjykatën se gjyqtarja relatore E.M. ka një ngarkesë prej 3822 çështjesh e aktualisht po gjykon çështje të periudhës janar-mars 2017.

45. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se edhe pse efektet e reformës në drejtësi nuk përbëjnë argument kushtetues në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave (*shih paragrafin 42 të vendimit*) dhe se situata nuk është në nivelet e duhura të eficientës dhe efikasitetit të masave të deritanishme të marra nga autoritetet që mund të çonin në evitimin e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, duket se KLGJ-ja ka marrë masa konkrete përmes përcaktimit të kalendarit të çështjeve në gjykatën e apelit.

iv. Çfarë përbën rrezik për kërkuar

46. Gjatë jurisprudencës së saj Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshejtim të posaçëm të gjykimin. Në këto raste duhet të merret



parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuarit në procesin gjyqësor, pra rëndësia për kërkuarin e së drejtës objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjake e jetësore”, siç janë ato të kujdestarisë, marrëdhëniet e punës, lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë (*shih vendimet nr. 39, datë 9.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*), të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë gjykimit nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm.

47. Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja është shprehur se në zbatim të parimit *minimis non curat praetor*, që pretendimet për cenimin e një të drejte të merren në shqyrtim prej saj, duhet të arrihet një nivel minimal rrezikshmërie. Përcaktimi i këtij niveli minimal është relativ dhe varet nga rrethanat e çështjes konkrete (*shih vendimin e GJEDNJ-së, Cecchetti kundër San Marino, datë 9.4.2013, § 29*).

48. Në rastin në shqyrtim, duke marrë parasysh shumën e detyrimeve të taksave vendore në ngarkim të kërkuarës (*shih paragrafin 2 të vendimit*), Gjykata çmon se çështja nuk është e një natyre të tillë që interesi i saj të rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore.

49. Në përfundim, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes konkrete, kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkuarës, si dhe sjelljen e autoriteteve, Gjykata vlerëson se nuk ka cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 26.5.2022

Shpallur më 27.6.2022

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë pro: Fiona Papajorgji. Altin Binaj.
Përparim Kalo. Elsa Toska. Sandër Beci

Anëtarë kundër: Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të vënë në lëvizje nga shoqëria “Elgakoti” sh.p.k. (*kërkuarja*), me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 8/14/6, datë 17.6.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosshqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm, jemi kundër qëndrimit të shumicës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej pranuar. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashatrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Në lidhje me rrethanat e faktit rezulton se në datën 26.8.2010 kërkuarja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesëpadi me objekt kundërshtimin e shkresës nr. 2, datë 5.5.2010 të Drejtorisë së Taksave, Elbasan, që në thelb lidhej me vendosjen e detyrimeve tatimore të vendosura nga Bashkia Elbasan. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 2507 (13-2010-4926), datë 9.12.2010, ka vendosur pushimin e gjykimit për shkak të mosparaqitjes së kërkuarës në seancë. Mbi bazën e ankimit të kërkuarës, në datën 25.11.2013 Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në datën 15.3.2017 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka konstatuar se nuk ishin respektuar rregullat e kompetencës lëndore, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, ku çështja është regjistruar në datën 11.5.2017.



3. Shumica ka parashtruar se kohëzgjatja e gjykimit administrativ të ankimit të kërkuës në shkallë të dytë është mbi 5 vjet, duke e llogaritur atë nga data e regjistrimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit mbi bazën e vendimit të Gjykatës së Lartë, që i ka dërguar çështjen për rishqyrtim si gjykatë kompetente. Mënyra e llogaritjes së kohëzgjatjes së gjykimit është një prej çështjeve që na ndan nga shumica, pasi vlerësojmë se kohëzgjatja nuk duhet llogaritur në mënyrë të izoluar vetëm në raport me regjistrimin e çështjes së kërkuës në Gjykatën Administrative të Apelit. Duke iu referuar thelbit të kërimit të kërkuës, e cila ankohet për gjykim tej afateve të arsyeshme të çështjes së saj në shkallë të dytë, dhe jurisprudencës kushtetuese, sipas së cilës kohëzgjatja llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor, deri në momentin kur jepet vendimi (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 34, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*), konstatohet se ankimi është regjistruar fillimisht në Gjykatën e Apelit Durrës në datën 14.2.2011. Nga kjo datë e deri në ditën e shqyrtimit kushtetues të çështjes në seancë plenare kanë kaluar 11 vjet, 3 muaj e 13 ditë pa pasur ende një vendimmarrje të gjykatës së shkallës së dytë për ankimin e kërkuës ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

4. Ndajmë të njëjtën qëndrim me shumicën se çështja duhej shqyrtuar në zbatim të kriterëve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, që lidhen me rrethanat e veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuës, kompleksitetin e çështjes, sjelljen e autoriteteve dhe rrezikun që sjell për kërkuësen tejzgjatja e afateve të gjykimit (*shih paragrafët 33–34 të vendimit*). Duke i zbatuar këto kriterë në çështjen konkrete, shumica, përfundimisht, ka vlerësuar se bazuar në rrethanat e çështjes konkrete, kompleksitetin e çështjes, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkuës, si dhe sjelljen e autoriteteve, nuk ka cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm (*shih paragrafin 49 të vendimit*).

5. Ashtu si edhe shumica, vlerësojmë se për sa i përket *sjelljes së kërkuës*, ajo ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak për vonesa në gjykimin e çështjes, të cilat mund të justifikonin vonesën në Gjykatën Administrative të Apelit (*shih paragrafin 36 të vendimit*).

6. Për sa i përket *kompleksitetit të çështjes*, konstatohet se objekti i ankimit në gjykatën e shkallës së dytë lidhet me verifikimin e shkakut të pushimit të gjykimit në shkallë të parë, pra nëse njoftimi i kërkuës ka qenë i rregullt dhe mosparaqitja e saj në seancë ka qenë pa shkaqe të arsyeshme. Për rrjedhojë, klasifikimi i saj si “*çështje që nuk paraqet rrethana të veçanta ose komplekse që mund të justifikojnë vonesat kohore në gjykimin e saj në Gjykatën Administrative të Apelit*” (*shih paragrafin 40 të vendimit*) duhet plotësuar, duke theksuar se rrethanat konkrete dëshmojnë se çështja është ndër më të thjeshtat nga pikëpamja juridike për t’u shqyrtuar.

7. Lidhur me kriterin e *sjelljes së autoriteteve*, shumica pranon se ligji nr. 49/2012 ka vendosur afate të shkurtra gjykimi, por situata nuk është në nivelet e duhura të eficiencës dhe efikasitetit të masave të deritanishme të marra nga autoritetet, që mund të çonin në evitimin e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore, duke marrë parasysh numrin e gjyqtarëve, i cili është ulur në 6 në Gjykatën Administrative të Apelit, numrin e lartë të çështjeve për shqyrtim prej saj, ngarkesën e punës së gjyqtarës relatore, ndonëse KLGJ-ja ka marrë masa konkrete përmes përcaktimit të kalendarit të çështjeve në gjykatën e apelit (*shih paragrafët 43–45 të vendimit*).

8. Në ndryshim nga shumica, çmojmë se në çështjen konkrete duhet të merret në konsideratë edhe sjellja e Gjykatës së Apelit Durrës, e cila me vendimin e saj nr. 10-2013-1822 (827), datë 25.11.2013 është shprehur për çështjen e kërkuës, duke mos respektuar rregullat e kompetencës lëndore, duke i dhënë në këtë mënyrë shkak Gjykatës së Lartë që të urdhëronte rigjykimin e çështjes në shkallë të dytë. Gjithashtu, ndonëse bëhej fjalë për një çështje të thjeshtë juridike – identifikimi i gjykatës kompetente në kohën kur gjykatat administrative të krijuara me ligj kishin filluar të funksiononin, Gjykatës së Lartë iu deshën më shumë se 3 vjet për ta shqyrtuar këtë çështje dhe për të urdhëruar rigjykimin në shkallë të dytë nga Gjykata Administrative e Apelit. Për rrjedhojë, në çështjen konkrete autoritetet nuk janë sjellë në mënyrën e duhur për të respektuar të drejtën e kërkuës për proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm.

9. Për sa i takon *rrezikun që sjell për kërkuësen tejzgjatja e afateve të gjykimit*, shumica ka vlerësuar se duke marrë parasysh shumën e detyrimeve për



taksat vendore në ngarkim të kërkuases, çështja nuk është e një natyre të tillë që interesi i saj të rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore, pasi nuk arrihet niveli minimal i rrezikshmërisë për marrjen në shqyrtim me prioritet të çështjes së saj (*shih paragrafët 46–48 të vendimit*).

10. Në parim jemi dakord se në ndryshim nga proceset gjyqësore ku vendosen të drejta vetjake dhe tepër të rëndësishme për individin, në rastin konkret interesi thelbësor i kërkuases në proces – kundërshtimi i taksave bashkiake të caktuara ndaj saj, *prima facie* nuk përbën interes prioritar, në kuptimin që gjykatat të kenë detyrimin të përshpejtojnë gjykimin. Megjithatë, duhet theksuar se verifikimi i rëndësisë të së drejtës materiale në procesin gjyqësor merr rëndësi dhe bëhet përcaktues në rastet kur kohëzgjatja e gjykimit, kompleksiteti i çështjes dhe sjellja e autoriteteve janë të tilla që vështirësojnë nxjerrjen e një përfundimi për respektimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Përdorimi i këtij kriteri në mënyrë të veçantë dhe zbatimi i tij si faktor përcaktues në çdo rast nuk përputhet me vlerësimin “*nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret*” që ka vendosur jurisprudenca kushtetuese (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, nëse ky kriter vlerësohet në mënyrë të veçantë dhe me vlerë përcaktuese për pranimin e ankimit të individëve, atëherë rrezikohet të cenohet thelbi i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt, sipas nenit 42 të Kushtetutës, duke e kufizuar/eliminuar atë për individët që zhvillojnë një proces gjyqësor për mbrojtjen e atyre të drejtave të ligjshme që nuk përfshihen në kategorinë e interesave prioritare.

11. Duke iu kthyer çështjes konkrete, rrethanat faktike tregojnë se kohëzgjatja e gjykimit në shkallë të dytë është haptazi e paarsyeshme (11 vjet, 3 muaj e 13 ditë në shkallë të dytë) në raport me natyrën juridike shumë të thjeshtë të çështjes (vlerësimi i shkaqeve të mungesës së kërkuases në seancë). Gjithashtu, rrethanat konkrete tregojnë se sjellje të caktuara të gjykatave dhe natyra e thjeshtë juridike e çështjes janë rrethana të mjaftueshme që ta detyronin gjykatën e shkallës së dytë të përshpejtonte çështjen. Ashtu siç ka normuar KLGJ-ja me vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, përbëjnë kritere të veçanta për përshpejtimin e

gjykimin, rastet e ankimit në gjykatën e shkallës së dytë ndaj vendimeve të pushimit të gjykatës së shkallës së parë (kreu II, pika 3.1, shkronja “e”) dhe çështjet për të cilat Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim (kreu II, pika 3.2, shkronja “a”). Është e vërtetë që ky vendim normativ i KLGJ-së parashikon se kërkesa për përshpejtimin e gjykimin duhet të paraqitet nga vetë pala ndërgjyqëse, por në rastin konkret kërkuësja e ka ushtruar një mjet të tillë, duke paraqitur kërkesën për përshpejtimin e procedurave sipas nenit 399/6, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, kërkesë e cila i është rrëzuar nga Gjykata e Lartë. Në këtë mënyrë, bazuar në detyrimin për shmangien e formalizmit të tepruar që duhet të karakterizojë gjykimin e kërkesave për përshpejtim (*shih vendimin nr. 37, datë 5.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*), kjo kërkesë duhet të ishte e mjaftueshme për të vënë në lëvizje Gjykatën Administrative të Apelit për të përshpejtuar gjykimin sipas vendimit të KLGJ-së.

12. Në përfundim, çmujmë se Gjykata duhet të kishte vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, që ka rrëzuar kërkesën për përshpejtimin e procedurave dhe detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm, duke vlerësuar edhe rrethanat që lidhen me numrin e ulët të gjyqtarëve, numrin e lartë të çështjeve dhe volumin e punës së trupit gjykues konkret në atë gjykatë.

Anëtare: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari

URDHËR
Nr. 167, datë 1.7.2022

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 17 dhe 21, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 17, pika 2, germa “k”, e rregullores, “Për organizimin e funksionimit e personelit dhe administrimin e dokumentacionit Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, të ndryshuar, neneve 9, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë



8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, për shkak të lejes vjetore të Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Manjola Kelolli, drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.

2. Delegimin e kompetencave, si nëpunës autorizues, për kryerjen e pagesave për të gjithë zërat e shpenzimeve (paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime), znj. Manjola Kelolli, drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.

3. Delegimin e kompetencave të mësipërme për periudhën 5.7.2022–19.7.2022.

4. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, znj. Manjola Kelolli.

5. Znj. Manjola Kelolli nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Laerta Rooze

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 3 (872), datë 5.5.2022, vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës së kërkuases Liljana Kuqeshi.

1. Heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Ardian Mbricë, i datëlindjes 28.2.1984, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të shtetases Liljana Kuqeshi.

2. Kufizimin e zotësisë juridike për të vepuar të shtetasit Gonë Mbricë, i datëlindjes 31.12.1980, si dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të shtetases Liljana Kuqeshi.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 384 lekë